

Rekomandimet e pa adresuara

Përmbledhje e rekomandimeve nga raportet e GAP lidhur me politikat publike

Instituti GAP në vazhdimësi ka analizuar politikat sektoriale dhe vendimet e qeverive duke dhënë rekomandime për përmirësimin e tyre dhe shmangien e keqpërdorimeve të parasë publike. Përveç disa rasteve, ka munguar vullneti i qeverive të kaluara për adresimin e problemeve të identifikuara, si dhe nuk janë hartuar politika që sipas gjetjeve tona do të kishin ndikim pozitiv në zhvillimin ekonomik të vendit. Ky dokument përmban rekomandime konkrete për përmirësimin e politikave në fuqi, që janë nxjerrë nga analizat dhe raportet e deritanishme të Institutit GAP rreth temave konkrete nga fusha e financave publike, energjisë, mbrojtjes sociale dhe më shumë.

- 2**— Politikat ekonomike dhe financat publike
- 6**— Energjia dhe Ambienti
- 8**— Mbrojtja sociale dhe çështjet gjinore
- 9**— Integrimi evropian
- 10**— Publikime

Politikat ekonomike dhe financat publike



Transparenca buxhetore dhe politikat fiskale

- Ministria e Financave duhet të fillojë me identifikimin e nevojave të biznesve dhe formave stimuluese për zhvillimin e mëtutjeshëm të tyre. Subvencionimi i pagave të punëtorëve, pushime nga tatimi në fitim, ulje të tatimit në të hyra, subvencionim të kontributeve për punëtorë, lirime nga tarifat lokale për ndërtim apo leje të ndryshme dhe grante për mbulim të pjesshëm të kostos së ndërtimit të objekteve nga investitorë janë disa nga format stimuluese që mund t'i përdorë qeveria;
- Ministria e Financave duhet të ndajë buxhet për rritje të numrit të inspektorëve për Administratën Tatimore të Kosovës (ATK), si masë për uljen e informalitetit;
- Ngjashëm sikur Rregullorja e MF-së nr.04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, që përmban kriteret për subvencionim të OJQ-ve, duhet të krijohet një rregullore e përgjithshme e cila paraqet disa parime bazë dhe format e rregullimit të subvencionimit nga institucionet publike.
- Përveç publikimit të dokumenteve, organizatat buxhetore duhet t'i kushtojnë rëndësi edhe formatit në të cilin i publikojnë dokumentet buxhetore. Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë (LPMFPP) duhet të amendamentohet që të kërkojë nga organizatat buxhetore (OB) që raportet financiare të publikohen në format të lexueshëm nga kompjuteri (për shembull Excel), në mënyrë që të ua lehtësojnë qytetarëve qasjen dhe përdorimin e të dhënave;
- Të gjitha organizatat buxhetore duhet t'i publikojnë Kartelat Analitike të Kontos në format të lexueshëm nga kompjuteri. Kartela duhet të publikohet në baza mujore dhe formati duhet të përcaktohet me udhëzim administrativ;
- Institucionet duhet të publikojnë të dhëna të detajuara për udhëtimet zyrtare jashtë vendit, duke përfshirë qëllimin, kohëzgjatjen, numrin e personave që kanë marrë pjesë në udhëtime zyrtare, emrat e pjesëmarrësve dhe shpenzimet buxhetore që ndërlidhen me udhëtimet;
- Tabelat e ligjit për buxhet duhet të publikohen në format të lexueshëm nga kompjuteri;
- MAPL duhet të monitorojë dhe nxisë implementimin e Udhëzimit Administrativ nr. 04/2018 për transparencë në komuna, konkretisht a) për të vlerësuar nëse janë duke u publikuar dokumentet e kërkuara buxhetore nga komunat, dhe b) nëse të njëjtat janë publikuar në bazë të fushave;
- Komunat duhet të angazhohen më shumë për të nxitur pjesëmarrjen e qytetarëve në dëgjime buxhetore dhe duhet të publikojnë procesverbalet e dëgjimeve buxhetore. Publikimi i procesverbeleve duhet të bëhet obligim ligjor;
- Ministria e Financave t'i publikojë të dhënat e detajuara për procesin e përfunduar të faljes së borxheve. Të dhënat të paraqiten të ndara në bazë të institucioneve dhe në bazë të kategorive të përfituesve (qytetarë, biznese, institucione).
- Me qëllim të rritjes së transparencës për burimin e financimit të komunave, në ligj duhet të specifikohet se Ligji për buxhetin çdo vit duhet të përmbajë një tabelë e cila e zbërthen financimin nga Granti i përgjithshëm për secilën komunë në bazë të kriterëve nga: a) shuma fikse; b) numrin e popullsisë; c) madhësinë gjeografike; d) numrin e popullsisë nga komuniteti jo shumicë, dhe e)

faktori i qëndrueshmërisë së komunave. Kjo gjithashtu u mundëson deputetëve dhe akterëve tjerë të informohen dhe monitorojnë sa po përfitojnë komunat burime shtesë si pasojë e komuniteteve pakicë.

- Ngjashëm sikurse Dogana e Kosovës e cila ka filluar të publikojë të dhëna të detajuara në formatin excel lidhur me importet, akcizat, tatimin doganor dhe TVSH-në, edhe Administrata Tatimore e Kosovës duhet të fillojë publikimin e të dhënave në excel. Disa nga datasetet që janë në interes për publikun, median dhe hulumtuesit janë: a) statistika të qarkullimit dhe tatimeve në bazë të sektorëve dhe të ndara në baza mujore. Të dhënat duhet të jenë të ndara deri në nivel katër shifror të klasifikimit NACE; b) databaza e bizneseve aktive të regjistruara në Kosovë të ndara në bazë të sektorëve sipas klasifikimit NACE; c) të dhënat për punësimin formal sipas klasifikimit sektorial NACE etj.
- Në mënyrë që të rritet bashkëpunimi i qytetarëve sa i përket raportimit të informalitetit në ATK, është esencial që procesi i ankesave në këtë institucion të reformohet. Për momentin, ATK kërkon që të shkohet fizikisht për dorëzimin e dëshmimeve dhe sipas interpretimeve të ATK-së qytetarët që kanë raportuar nuk kanë të drejtë të informohen nëse janë marrë masa ndaj ndonjë biznesi për shkak të raportimit të tyre. Kjo ndikon që besueshmëria dhe raportimi nga qytetarët të ulen dukshëm sa i përket luftës ndaj informalitetit.
- Përveç raportimit nga qytetarët, edhe raportimi nga shërbyesit civil për keqpërdorime është në nivel të ulët. Ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve nuk është promovuar sa duhet dhe mekanizmat brenda institucioneve nuk janë duke funksionuar. Për këtë arsye, një një studim tonin, kemi gjetur se një pjesë e madhe e shërbyesve civil nuk do të raportonin për keqpërdorime nga frika e humbjes së vendit të punës apo mungesës së informacionit për të drejtat e tyre.
- Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka realizuar studime të reja dhe ka publikuar të dhëna agregate në platformën askdata krahas raporteve përshkruese të përmbledhura për të dhëna të ndryshme. Sidoqoftë, këto të dhëna shërbejnë vetëm për kuptim të përgjithshëm të çështjeve. ASK nuk i ndan databazat e anketave me palët e interesuara duke u thirrur në çështje të konfidencialitetit ose anonimitetit të të anketuarve. Meqenëse Kosova tashmë ka filluar iniciativën e saj për të dhëna të hapura, publikimi i databazave në format excel, csv, dhe dta duhet të jetë obligim ligjor. ASK duhet të publikojë secilën databazë, përfshirë: bazën e të dhënave të Llogarive Kombëtare, bazën e të dhënave të Statistikave Ekonomike, bazën e të dhënave të Statistikave Sociale dhe bazën e të dhënave të Bujqësisë dhe Mjedisit. Gjithashtu, ASK duhet të ndajë buxhet për pastrimin dhe përpunimin e të dhënave, përfshirë punësimin e ekspertëve në krijimin e bazave të të dhënave duke siguruar konfidencialitetin dhe anonimitetin e të anketuarve në vijë me standardet e EUROSTAT-it.

Sigurimi i një procesi buxhetor që siguron pavarësinë e prokurorisë dhe gjyqësorit

Kapacitetet e kufizuara profesionale të Komisionit Parlamentar për Buxhet dhe Financa, kufizimet kohore të parlamentit për të shqyrtuar në hollësi buxhetin, mungesa e dëgjimeve të rregullta buxhetore me Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK) dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK) si dhe mungesa e të dhënave të krahasueshme me vendet e tjera janë disa nga arsyet që mund të çojnë në kapacitete të kufizuara buxhetore të KGJK-së dhe KPK-së për të përmbushur efektisht misionet e tyre.

- Siç rekomandohet nga Këshilli i Evropës, përfshirja e KGJK-së dhe KPK-së gjatë ndarjeve buxhetore duhet të jetë e detyrueshme dhe të sigurohet me ligj;
- Parlamenti i Kosovës duhet të përdorë pika referuese dhe të sigurojë argumente transparente për publikun kur mbështet ose refuzon kërkesat buxhetore të KGJK-së dhe KPK-së. Përveç sigurimit të transparencës në proces, kapacitetet profesionale të stafit të Komisionit për Buxhet dhe Financa duhet të rriten;
- Me qëllim të krijimit të pikave referuese që mund të përdoren për hartuesit e politikave dhe palët e tjera të interesit, KGJK dhe KPK duhet të publikojnë të dhëna sipas metodologjisë së Këshillit të Evropës, CEPEJ, ndërsa BE duhet të vazhdojë të mbështesë nismat që rrisin kapacitetet e gjykatave dhe të prokurorive për t'i publikuar të dhënat sipas kësaj metodologjie.

Maksimizimi i kthimit ekonomik dhe social nga investimet kapitale

Instituti GAP e sheh si shumë të nevojshme vendosjen e kritereve për rregullimin e investimeve publike kapitale. Një nga problemet kryesore deri më tani sa i përket ndarjes së investimeve kapitale ka qenë mungesa e transparencës dhe diskrecioni i madh që i është dhënë ministrive/komunave në ndarjen e këtyre investimeve. Ndarja e buxhetit për investime kapitale duhet të bazohet në metoda objektive dhe të verifikueshme. Këto metoda duhet të përfshihen në legjislacion, ngjashëm me praktikën në Bashkimin Evropian (BE). Praktika të mira të rregullimit të investimeve nga fondet publike janë këto rregullore të BE-së: Rregullorja (BE) nr. 1303/2013; Rregullore e Deleguar e Komisionit (BE) nr. 480/2014; Rregullore e Komisionit për Implementim (BE) nr. 1011/2014; Regulation (BE) nr. 1299/2013. Ngjashëm, edhe në Kosovë duhet të draftohet një udhëzim administrativ me rregulla të tilla.


- Për investimet kapitale të ministrive në komuna të krijohet një fond në të cilin të gjitha komunat kanë të drejtë të aplikojnë me projekte. Të gjitha këto projekte dhe procesi i aplikimit duhet të jetë transparent dhe vetëm projektet me ndikimin më të madh pozitiv ekonomik dhe financiar të financohen.
- Dy hapa tejet të rëndësishëm për t'u ndërmarrë para hyrjes në fuqi të një udhëzimi administrativ: 1) hartimi i manualit me shpjegimet për hapat dhe metodat e parapara në legjislacion dhe që duhet ndjekur për vlerësimin e projekteve kapitale dhe 2) trajnimi i gjithë zyrtarëve të organizatave buxhetore (OB-ve) në përdorimin e këtyre teknikave për vlerësim;
- Vlerësimet e projekteve nga OB-të dhe MF duhet të bëhen transparente në faqen zyrtare të MF-së dhe komunave përkatëse;
- Vlerësimi para dhe pas implementimit të projektit. Në UA duhet të parashihet që përveç vlerësimit para implementimit të projektit, të bëhet edhe një vlerësim pas implementimit me qëllim që të matet nëse janë arritur qëllimet;
- Efekti në punësim (ex post). Me qëllim të matjes së efektit të investimeve kapitale në punësim, kompanitë të cilat implementojnë projekte kapitale duhet të ofrojnë dëshmi për këto indikatorë: 1) numri i të punësuarve më orar të plotë dhe të pjesshëm; 2) paga mesatare; 3) kontratat e punëtorëve; dhe 4) dëshmi për pagesën e taksave dhe kontributit pensional për punëtorë;

Menaxhimi i ndërmarrjeve publike

- Qeveria e Kosovës të reformojë mënyrën e përzgjedhjes së bordeve. Si mënyrë për të përmirësuar procesin: a) të delegojë procesin e rekrutimit të anëtarëve të bordeve tek kompanitë private të rekrutimit; b) të bëjë transparent për publikun procesin e zgjedhjes së bordeve; c) të publikojë online metodologjinë e vlerësimit dhe biografitë e kandidatëve;
- Qeveria e Kosovës si mënyrë për diversifikimin e zërave në ndërmarrje dhe rritjes së përkrahjes gjatë proceseve ristrukturuese të shqyrtojë mundësinë që pjesë e bordeve me të drejtë vote të jenë edhe përfaqësues të punëtorëve të NP-ve;
- Ndërmarrjet publike të ofrojnë alternativa për konsumatorët për pagesën e detyrimeve, si për shembull të krijohen marrëveshje përmes së cilave përcaktohet ndalesa automatike e një përqindjeje të rrogës nga llogaria e konsumatorëve;
- Ndërmarrjet publike duhet të përdorin softuer për identifikimin e konsumatorëve më likuidë, konsumatorëve me rrezik më të madh për mos pagesë dhe borxhlinjëve më të mëdhenj.

Çështje ekonomike dhe tregtare

- Në kuadër të marrëveshjes së CEFTAs, Kosova duhet të provojë që së bashku me Shqipërinë dhe shtetet tjera të rinegociojë mekanizmat brenda CEFTAs për zgjidhjen e barrierave tregtare;
- Në strategjinë e re tregtare të Kosovës duhet të përfshihet edhe analiza për përfitimet apo humbjet e Kosovës në rast të anëtarësimit në Unionin Doganor Ballkanik. Gjithashtu, duhet që module të ndryshme të unionit doganor të diskutohen në këtë dokument nëse ato janë të përshtatshme për gjendjen aktuale politike dhe tregtare të Kosovës;
- Qeveria e Kosovës së bashku me prodhuesit e ujit të ambalazhuar, duhet të diskutojë lidhur me obligimet e papaguara të këtyre prodhuesve ndaj shtetit të Kosovës. Çdo falje e borxheve ndaj sektorit privat, duhet të kalojë përmes Kuvendit të Kosovës;
- Në fushën e konkurrencës, kompanisë “Eurolab” duhet t’i hiqet mbikëqyrja e qendrave të tjera të kontrollimit teknik sepse kjo paraqet konflikt interesi ngase e njëjta kompani për momentin kryen kontrollën e parë teknike;
- Të largohet neni i udhëzimit administrativ, i cili kushtëzon që kontrolli i parë teknik të kryhet nga kompania për homologim. Kjo pasi që bie ndesh me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe të drejtën e konsumatorit për të zgjedhur.



Energjia dhe Ambienti

- Kontrata e nënshkruar mes Qeverisë së Kosovës dhe kompanisë amerikane ContourGlobal është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe Traktatit të Komunitetit të Energjisë (TKE) mbi Ndihmën Shtetërore. Nëse ky projekt hyn në funksion, tregu i energjisë elektrike në Kosovë në esencë do të mbyllet për 20 vite, duke bllokuar kështu zhvillimin e çfarëdo konkurrence dhe minimizon shanset dhe stimujt për liberalizim të tregut të energjisë. Po ashtu, sipas një skenarit të përgatitur nga ne, hyrja në operim e TC “Kosova e Re” në vitin 2023, duke marrë parasysh edhe investimet tjera të planifikuara në fushën e energjisë, do t’i rriste tarifën e energjisë elektrike për 60.4% duke i bërë ato të pabërballueshme për qytetarët dhe bizneset në Kosovë.
- Duhet të hartohet një plan për trajtimin e humbjeve teknike dhe komerciale të energjisë elektrike pasi që ato vazhdojnë të jenë shumë të larta. Specifikisht, investimet e bëra nga KEDS deri më tani në rrjetin e shpërndarjes nuk kanë rezultuar të jenë të mjaftueshme për të evituar humbjet teknike dhe komerciale. Humbjet komerciale dhe teknike të pranuar nga ZRrE, dhe që paguheshin nga qytetarët përmes tarifave të energjisë elektrike, janë mbi 22% të kërkesës në shpërndarje. Thënë ndryshe, janë mbi 1400 GWh të humbura, që nuk konsumohen nga qytetarët por që paguhet për to, apo rreth 8 herë më shumë se sa prodhimi i gjithmbarshëm nga BRE.
- Para se të vendoset për ndërtimin e një termocentrali të ri, nëse nuk bëhet rivitalizimi i TC “Kosova A”, duhet që fillimisht:
 - Të bëhet një vlerësim i hollësishëm lidhur me nevojën për investim në efikasitet të energjisë, sidomos në sektorin e amvisërive. Bazuar në gjetjet e disa raporteve, në Kosovë shfrytëzohet dy herë më shumë energji elektrike për ngrohjen e një hapësire sesa në Europë. Po ashtu, efikasiteti dhe sobave (stufave) që përdoren për ngrohje del të jetë më e vogël se 70%.
 - Të bëhen përmirësime në rrjetin e shpërndarjes në lagjet e qendrës së Prishtinës, që sipas të gjeturave tona, janë lagjet të cilat kanë pasur kursimin më të vogël të energjisë elektrike si pasojë e funksionimit më të dobët të ngrohjes qendrore;
 - Të bëhet një studim nga vet Termokos-i për numrin e konsumatorëve që dëshirojnë të lidhen me këtë ngrohës, dhe rrjedhimisht të përpilohet një plan afatmesëm për kërkimin e granteve apo kredive shtesë për lidhjen e më shumë konsumatorëve;
 - ZRrE duhet të dizajnojë tarifa nxitëse për promovimin e ndërtimit të ngrohësve të reja në Kosovë;
 - Duhet të shikohet mundësia e ndërtimit të ngrohësve të re në Drenas, e cila do të lidhej me “Ferronikelin”;
 - Qeveria bashkë me ZRrE-në të krijojë kushte më të favorshme përmes incentivave fiskale dhe tarifore në mënyrë që të rriten investimet private në ngrohës qendrore;
 - Të përpilohet një plan strategjik institucional për identifikimin e energjisë termike të pashfrytëzuar, si dhe përcaktimin e civeve të prodhimit përmes burimeve të ripërtëritshme;

Të gjitha këto pika, do të jepnin një pasqyrë të qartë rreth kërkesës reale për energji elektrike në Kosovë dhe nevojës për mbeshtetje në rritjen e efikasitetit të energjisë. Konkretisht, duke u bazuar në kërkesën për siguri të furnizimit me energji elektrike sipas direktivave të BE-së, dhe gjetjet e një analize që duhet të bëjë ZRrE lidhur me atë se si ndikon në nevojën për kapacitete energjetike futja në funksion e linjës së transmisionit më Shqipërinë dhe krijimi i një tregu të përbashkët të energjisë më Shqipëri, do të arrihej tek kapaciteti i nevojshëm që duhet të ketë termocentrali i ri në dhe caqet tjera nga BRE.

- Nëse vendoset të ndërtohet një termocentral i ri, para se të nënshkruhen marrëveshjet përfundimtare nga qeveria të njëjtat duhet të analizohen dhe miratohen fillimisht nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRrE), e më pas edhe nga zyra për ndihmë shtetërore;
- Bashkëpunimi energjetik ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë duhet të intensifikohet edhe më tej me ndihmën e qeverive të të dy vendeve. Ky bashkëpunim duhet të rezultojë në:
 - Krijimin e një tregu të përbashkët të energjisë;
 - Konkretizimin e planeve strategjike për bashkëpunim energjetik ndërmjet të dy vendeve;
 - Luftimin e pengesave të bashkëpunimit energjetik, si korrupsioni;
 - Nënshkrimi i marrëveshjes së ujërave ndërkufitar për përdorim energjetik.
- ZRrE duhet të angazhojë kompani për të bërë auditimin e investimeve kapitale të bëra veçanërisht nga KEDS e cila, sipas ZRrE, deri më tani nuk e ka zbatuar Ligjin për prokurimin publik të Kosovës siç e obligon licenca e saj. Po ashtu, nevojitet një raport i auditimit të performancës së këtyre investimeve pasi që nuk dihet se si kanë ndikuar ato në uljen e humbjeve teknike dhe komerciale të energjisë të cilat mbulohen nga qytetarët.
- Me qëllim të nxitjes së qytetarëve për blerjen e makinave që plotësojnë standardet ambientale, atëherë të krijohen skema me anë të të cilave akciza në vetura llogaritet në bazë të plotësimit ose jo të këtyre standardeve dhe jo vetëm në bazë të kubikëve.
- Duhet të krijohet një plan veprimi lidhur me menaxhimin e cilësisë së ajrit, ku paraqiten masa konkrete që e përmirësojnë cilësinë e ajrit.

Mbrojtja sociale dhe çështjet gjinore

Skema e Ndhmës sociale, si programi i vetëm qeveritar që orientimin e ka specifikisht në uljen e varfërisë, duhet të pësojë ndryshime sikurse:



- Të rriten ndjeshëm pagesat mujore për familjet si pjesë e skemës pasi që kompensimet aktuale nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e familjeve aq edhe sa kërkon pragu i varfërisë së skajshme në Kosovë;
- Duhet të largohet kriteri i moshës nga kategoria II e skemës së ndihmës sociale, që familja të ketë një fëmijë deri në 5 vjeç pasi që i njëjti ndikon që familjet të zhyten edhe më shumë në varfëri. Konkretisht, ky kriter i shtynë familjet që të rrisin numrin e fëmijëve vetëm që të mbesin pjesë e skemës. Po ashtu, të dhënat tregojnë që skema aktuale nuk është e dizajnuar asisoji që t`i targetojë si duhet të varfërit. Për shembull, nga të gjitha familjet e varfëra në Kosovë 20% janë familje me 5 ose më shumë anëtarë, ndërsa në skemën aktuale të ndihmës sociale vetëm 5 deri 8% e përfituesve janë të këtij profili. Qeveria duhet të hartojë kriteret e mjaftueshme në testin e varfërisë që targetojnë saktë familjet e varfëra, dhe skema e ndihmës sociale duhet të përmbajë stimulime shtesë krahas atyre aktuale në mënyrë që t`u rrisë gjasat familjeve që sa më parë të ikin nga pragu i varfërisë;
- Borxhet e mbledhura ndër vite që kanë familjet nën skemën e asistencës sociale ndaj institucioneve shtetërore dhe ndërmarrjeve publike, Qeveria e Kosovës t`i falë me automatizëm;
- Qeveria do të duhej të targetonte familjet nën skemën e asistencës sociale përmes fondeve për investim në efikasitet të energjisë, si pjesë e Planit të 4 Nacional të Veprimit për Efikasitet të Energjisë, pasi që të njëjtat përkundër që e kanë të mbuluar një sasi të konsiderueshme të energjisë elektrike, shpenzojnë mjete shtesë për energji elektrike për shkak të izolimit të dobët të shtëpive/banesave të tyre;
- Aktualisht vetëm një e treta e përfituesve të skemës së ndihmës sociale janë gra. Sipas një studimit tonë, gratë kryefamiljare në Kosovë, për dallim nga burrat kryefamiljarë, shpenzojnë më shumë për shëndëtesë dhe produkte që e rrisin mirëqenien e më pak për duhan. Andaj, qeveria duhet të rrisë numrin e bartëseve gra të ndihmës sociale kur një gjë e tillë është e mundur. Një hap i tillë do të rezultonte në një politikë më optimale dhe rritje të mirëqenies.
- Duhet të bëhet kategorizimi përfundimtar bazuar në listat aktuale të veteranëve të luftës, në mënyrë që të bëhet i zbatueshëm neni 16 A paragrafi 2 i Ligjit për veteranët e luftës, që kërkon që buxheti për këtë skemë të mos kalojë 0.7% të BPV. Aktualisht, kompensimi i kësaj kategorie është mbi 1% e BPV.
- Përfaqësimi i grave në bordet e ndërmarrjeve publike dhe institucioneve e agjencive të pavarura është shumë i ulët. Rreth 85% e anëtarëve të bordeve të ndërmarrjeve publike janë burra dhe 15% gra. Po ashtu, 81% e anëtarëve të bordeve në institucione dhe agjenci të pavarura janë burra, 16% janë gra dhe për pesë anëtarë nuk ka informacione. Në këtë pikë, është e rëndësishme që të gjejë zbatim neni 34 i Ligjit për shoqëritë aksionare që kërkon që 40% anëtarëve të bordit të drejtorëve të shoqërisë aksionare të jenë gra. Realisht, sipas nenit të njëjtë, kuota duhet të ngritet në 50% pas dy viteve të zbatimit të ligjit.
- Në shërbimin civil të Kosovës, mbi 94% e pozitave të larta menaxheriale dominohen nga burrat. Të gjithë 1,562 titujt e vendeve të punës në shërbimin civil janë në gjininë mashkullore. Në Ligjin për barazi gjinore dhe në Ligjin e punës të kërkohet që titujt e pozitave nëpër konkurse të përfshijnë gratë

e burrat bashkë si për shembull Menaxher/Menaxhere, Receptionsist/Receptioniste, Zyrtar i Lartë/Zyrtare e Lartë. Këto ndryshime duhet të bëhen edhe tek këto dy dokumente: “Titujt e vendeve të punës në katalogun e vendeve të punës në shërbimin civil të Kosovës”, dhe “Përshkrimi i detyrave të punës për titujt e vendeve të punës”. Këto masa do të eliminonin stereotipat gjinor mbi ndarjen e profesioneve ndërmjet gjinive si dhe në përgjithësi do të kontribuonin në rritjen e shkallës së punësimit të grave, meqë numri i grave si punëkërkuese të regjistruara është gati i barabartë me atë të burrave, që nënkupton se gratë janë po aq të interesuara për punë sa edhe burrat.

- Projektbuxheti nuk e merr parasysh perspektivën gjinore. Ligji për barazi gjinore kërkon që perspektiva gjinore të futet në çdo fazë të procesit të planifikimit, miratimit, zbatimit dhe vlerësimit të legjislativitetit. Mirëpo, vlerësimi gjinor i buxhetit nuk është bërë në asnjërin nga dokumentet e buxhetit qoftë në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve apo Projektligjin për ndarjet buxhetore.
- Ndikimi gjinor. Në përputhje me Ligjin për barazi gjinore në vlerësimin e projekteve kapitale duhet të futet edhe një kriter sa i përket ndikimit gjinor të projektit. Projektet të cilat ndihmojnë në zbutjen e papunësisë apo problemet më të cilat ballafaqohen një gjini e caktuar duhet të shpërblehen me pikë shtesë.
- Mbrojtja e konsumatorëve. Si pjesë e Këshillit për Mbrojtjen e Konsumatorit, kemi realizuar një studim për mbrojtjen e konsumatorëve në sektorin bankar. Rrjedhimisht, kemi gjetur se jo të gjitha bankat komerciale në Kosovë publikojnë në ueb-faqet e tyre informata rreth kostos së kredisë në vijë me rregullat e BQK-së. Në rolin e vet për mbrojtjen e konsumatorëve, BQK nuk ka bërë mjaftueshëm në shpërndarjen e informatave për të arritur edukimin financiar të një numri të madh të qytetarëve. Andaj, në këtë drejtim, BQK do të duhej të monitorojë respektimin e Rregullores për normën efektive të interesit dhe të publikojë të dhëna të përmbledhura nga bankat komerciale lidhur me tarifën dhe normat e interesit nominale dhe efektive. Gjithashtu, BQK duhet të matë njohuritë e qytetarëve përmes iniciativave për edukim financiar dhe të përmirësojë dhe promovjë platformën e edukimit financiar.

Integrimi evropian

- Me ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA) nga Kuvendi i Kosovës, Kosova ka marrë përsipër përbushjen e të gjitha kushteve që dalin nga ky dokument. Roli i komunave në agjendën integruese të vendit është i rëndësishëm. Aktualisht, janë 146 masa konkrete të cilat duhet t'i arrijnë komunat për t'u konsideruar të përbushura obligimet e nivelit lokal që ka Kosova me MSA. Edhe pse, Ministria e Integrimit Evropian (MIE), në nivel vendi e ka menaxhuar procesin e përbushjes së kushteve që dalin nga MSA, në të ardhmen duhet të ketë bashkëpunim të ngushtë të nivelit qendror me zyrtarë të integritimeve evropiane nëpër komuna, me qëllim të diskutimit të problemeve dhe të arritave nga pushteti lokal në përbushjen e MSA-së, si dhe Komisioni Parlamentar për Integritime Evropiane duhet t'i thërrasë në dëgjime udhëheqësit e ministrisë përkatëse për të vlerësuar nivelin e përbushjes së MSA-së nga niveli lokal.
- Agjenda për Reforma Evropiane (ARE) ishte lansuar si dialog i nivelit të lartë në mes BE-së dhe Kosovës në mënyrë që ta përshpejtojë zbatimin e MSA. Procesi i monitorimit tonë vërteton se qeveria nuk ka treguar ndonjë përkushtim të qartë për të ndërmarrë reformat e nevojshme të theksuara në këtë dokument, që në mënyrë adekuate ta luftojë korrupsionin dhe krimin e organizuar, përmirësojë mjedisin biznesor, reformojë administratën publike dhe sigurojë një proces transparent, të bazuar në meritë dhe jo-politik të përzgjedhjes. Për arritjen e rezultateve më të mira, qeveria duhet ta rritë përkushtimin e saj drejt realizimit të reformave të domosdoshme dhe vendimtare.




Publikime

Për më shumë rreth çështjeve të ngritura më lartë shih raportet e Institutit GAP:




bit.ly/367vKd2

Indeksi i Transparencës Buxhetore të Komunave 2018




bit.ly/2OYSs1r

Efektet e Ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar




bit.ly/33XO1rA

Efektet e Ligjit për Faljen e Borxheve



bit.ly/33UU8gn

Ndikimi i Termocentralit "Kosova e Re" në Tarifat e Energjisë Elektrike




bit.ly/2Sc4NRS

Ndikimi i ndihmës shtetërore në tregun e energjisë elektrike në Ballkan



bit.ly/2DOsBCV

Shfrytëzimi i energjisë elektrike për ngrohje. Ndikimi i kogjenerimit në konsum të energjisë




bit.ly/2YIZzEg

Bashkimi bën energjinë. Analizë e tregut të përbashkët energjetik




bit.ly/2Y9n7f2

Menaxhimi i buxhetit familjar: gratë dhe burrat



bit.ly/37YTYb2

Përfaqësimi i grave në bordet e ndërmarrjeve publike dhe agjencive të pavarura



bit.ly/2DDWe9l

Diskriminimi në tregun e punës. Ndikimi i konkurseve në pabarazinë gjinore



bit.ly/2LLOPvh

Mbrojtja e konsumatorëve në sektorin bankar



bit.ly/2Etw5uN

Zbatimi i MSA-së në nivel komunal